

NR. /

II/645

Data 30.06.2020
Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA E OBILIQT-KOSOVË / OPŠTINA OBILIC - KOSOVO / MUNICIPALITY OF OBILIC - KOSOVO

Në mbështetje të nenit 26 Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Kosovës si dhe Rregulloren Nr.21/2012 Procedura e Avancimit, Rregulloren Nr.02/2010 Procedura e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Obiliqit me datën 30.06.2020, shpall:

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita: Auditor i Brendshëm ✓

Lokacioni/ vendi i punës: Komuna e Obiliqit, Njësia e auditimit të brendshëm

Koeficienti : 15

Lloji dhe vendi i punës: I karrierës

Detyrat kyçe:

1. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për bërjen e auditimeve edhe shërbimeve përkatëse;
2. Kryen/udhëheq auditime, përfshirë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
3. Përgatit draft raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bënë intervistën përfundimtare;
4. Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e auditimit, dhe dorëzon atë për arkivim;
5. Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve dhe njësive organizative;
6. Ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët në njësinë e auditimit të brendshëm për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
7. Ofron këshilla për çështje të auditimit të brendshëm brenda institucionit, sipas nevojës;
8. Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës

Shkathtësitë e kërkuara :

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike apo financa publike - minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Të ketë certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e auditimeve;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Të interesuarit aplikacionit duhet t'ia bashkëngjisin këto dokumente – kopjen e diplomës arsimore , nëse përgatitja shkollore - diploma është nga shtetet tjera duhet të verifikohet në Ministrinë e Arsimit, dëshmi për përvojën e punës, kopjen e letërnjoftimit.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të aplikacioneve, Komisioni mund të verifikojë me institucionet përkatëse vërtetësinë e të dhënave të siguruar nga kandidatët.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacionin me të dhëna të sakta . Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave ose ofrimit të informativë të rrejshme, aplikacioni refuzohet.

Aplikacionet e kandidatëve të cilët kanë dosje personale kriminale, e cila , sipas Ligjit për Shërbimin Civil konsiderohet e pa përshtatshme për emërim në Shërbimin Civil, do të refuzohet.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën Pritëse .

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 8 (tetë) ditë nga data e publikimit . Dokumentet e pa kompletuara dhe të arritura pas afatit nuk do të merren në shqyrtim . Në këtë konkurs kanë të drejtë konkurrimi vetëm nëpunësit civil ekzistues. Kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të njoftohen për intervistë përmes tabelës së shpalljeve dhe telefonit. Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabart të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femrore nga të gjitha komunitete në Kosovë .

Kryetar i Komunës


Xhafer Gashi

